



GSRM

KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

Material Infomues

INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E BONOVE TË THESARIT QË APLIKOHEN NGA BANKA KOMBËTARE TREGËTARE

1. Për blerje Bono Thesari në tregun primar, pjesëmarrja në ankand nëpërmjet BKT-së aplikohet me një komision fillestar 1,000 lekë dhe në maturim të bonos aplikohet një komision 0.2 % mbi vlerën nominale të bonos.

Shembull:

Nëse klienti do të marrë pjesë në ankand për një vlerë nominale prej 1,000,000 lekë, në ditën e aplikimit do të paguajë 1,000 lekë dhe në datën e maturimit të Bonos së Thesarit do të paguajë 2,000 lekë.

$$1,000,000 * 0.2\% = 2,000 \text{ lekë}$$

2. Për blerje të Bonove të Thesarit nga portofoli i BKT-së **nuk aplikohet asnjë komision**. Në këtë rast klienti do të paguajë shumën që llogaritet në bazë të çmimit të kuotuar për ditët e mbetura deri në maturim.

Shembull:

Nëse klienti do të blejë Bono Thesari nga portofoli i Bankës për një vlerë nominale 1,000,000 dhe maturohet pas 200 ditësh, dhe nëse BKT shet nga portofoli me 6.7%, çmimi i blerjes llogaritet si më poshtë:

$$1,000,000 / (1 + 0.067 / 365 * 200) = 964,587.74 \text{ lekë}$$

3. Për shitje të Bonove të Thesarit para datës së maturimit **nuk aplikohet asnjë komision**. Në këtë rast klienti do të paguajë shumën që llogaritet në bazë të çmimit të kuotuar për ditët e mbetura deri në maturim.

Shembull:

Nëse klienti do të shesë Bono Thesari para datës së maturimit për një vlerë nominale 1,000,000 lekë dhe maturohet pas 160 ditësh, dhe nëse BKT blen me 7.7%, çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$1,000,000 / (1 + 0.077 / 365 * 160) = 967,348.67 \text{ lekë}$$